

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE

FURRË DJEGIEJE PËR ASGJESIMIN E MBETJEVE TË RREZIKSHME, MBETJEVE
MJEKËSORE DHE MEDIKAMENTEVE

BREMA AMBIENTE SHPK

2024



Tabela e përmbajtjes

1. HYRJE	2
1.1 Qëllimi i raportit të VNM-së	3
1.1.1 Përshkrimi i metodologjive të përgatitjes së raportit VNM.....	4
2. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT	5
3. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT DHE QËLLIMI	7
4. PROCESI TEKNOLOGJIK	9
5. MENAXHIMI I INSTALIMIT	12
6. NDIKIMET NEGATIVE NË MJEDIS	13
Ndikime në ujëra	14
Ndikime në tokë	14
Ndikime në ajër	15
Ndikime në zhurma.....	16
7. MASAT KRYESORE LEHTËSUESE	18
8. MONITORIMI I PLANIFIKUAR	20

1. HYRJE

Kjo përmbledhje joteknike hartohet me kërkesë të zhvilluesit Brema Ambiente Sh.p.k, i cili do të paraqesë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dokumentacionin e nevojshëm për aplikim për VNM të thelluar për aktivitetin:

"Furrë djegieje për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve mjekësore e medikamenteve".

Subjekti BREMA AMBIENTE sh.p.k i regjistruar ne QKB me numer NIPT: L22316011G operon permes Kontrates se Konkensionit se dates 17.10.2012, nr. 3317 Rep, Nr. 1305 Kol, Parkun Industrial te Rrashbullit.

Shoqeria eshte e pajisur me leje mjedisi te tipit A me numer: PN-0874-12-2021 me objekt aktiviteti: Menaxhimi i mbetjeve.

Raporti i VNM-së së Thelluar dorëzohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), si pjesë e dosjes prezantuese të projektit së bashku me raportin e dëgjësës me publikun, për të dhënë një vështrim të përgjithshëm mbi rezultatet e të gjithë procesit.

Dokumentacioni paraqet projektin, një përshkrim të gjendjes aktuale të mjedisit fizik, biologjik dhe social në zonën e projektit, ndikimet kryesore në mjedis dhe ato sociale, përcakton masat e planifikuara për të parandaluar, minimizuar, zbutur dhe shmangur këto ndikime. Raportet pjesë e dosjes së aplikimit, janë përgatitur nga një grup konsulentësh të pavarur.

VNM-ja është kryer në përputhje me rregullat dhe standartet që zbatohen në Shqipëri për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Ky projekt për vlerësim po kryen njoftimin për procedurën e VNM-së së Thelluar, sipas Vendim Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", i ndryshuar me VKM nr. 828, datë 28.12.2023, Dëgjësën me publikun

sipas Vendim Nr. 419, datë 25.6.2014 dhe më pas do të kryejë të gjitha hapat për ndryshim të kushteve të lejes mjedisore, pas pajisjes me vendimet përkatëse.

Aktiviteti: "Furrë djegieje për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve mjekësore e medikamenteve".

sipas legjislacionit ne fuqi klasifikohet si objekt i VNM-së, konkretisht:

Klasifikimi ne baze te LIGJ Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 "PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS", i ndryshuar:

SHTOJCA I

PROJEKTET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS SË THELLUAR TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Pika 9.

Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, ose venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

Per kete eshte pergatitur nje Raport Teknik detyrim per fillimin e procedures se VNM-se te Thelluar, per te vazhduar me tej me kerkesen per Deklarate Mjedisore dhe kerkesen per ndryshim te kushteve te lejes se tipit A, leje aktive e subjektit BREMA AMBIENTE SH.P.K, leje mjedisi me numer: PN-0874-12-2021, per shtimin ose instalimin e teknologjive te reja ne sherbim te aktivitetit qe zhvillohet ne Parkun Industrial.

1.1 Qëllimi i raportit të VNM-së

Objektivat e VNM-së janë që:

- Të japë informacion për sfondin e projektit dhe ndërveprimet e mundshme të tij me receptorët mjedisorë e socialë në zonën e projektit.
- Të identifikojë ndikimet e mundshme të projektit të hartuar.
- Të konsultohet me palët e interesit dhe me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe të marrë opinionet e tyre për projektin.

- Të përmbushë kërkesat e procedurës së VNM-së sipas legjislacionit Shqiptar.
- Të informojë palët e interesit dhe publikun në tërësi për ndikimet e implementimit të kësaj teknologjie, të marrë opinionet dhe shqetësimet e tyre dhe t'i përfshijë ato në studim.
- Të mundësojë kontributin e të gjithë palëve të interesit përmes një procesi të vrojtimit social dhe dëgjësës publike. Në këtë fazë të zhvillimit të projektit, është përgatitur draft Raporti VNM dhe do të dorëzohet pranë autoritetit rregullator (MTM). Kjo shënon fillimin e procedurës së njoftimit dhe fushatës së komunikimit të projektit e cila zgjat 30 ditë dhe pasohet nga Dëgjesa Publike në zonën e projektit. Kërkesat, shqetësimet dhe sugjerimet e këtyre fazave do të analizohen dhe adresohen në versionin final të Raportit VNM-së.

1.1.1 Përshkrimi i metodologjive të përgatitjes së raportit VNM

Fazat	Shënime
1.	Inspektimi në terren për procesin e përcaktimit të çështjeve të VNM-së
2.	Njoftimi për VNM të thelluar në institucionet përkatëse; Ministria e Turizimit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit
3.	Kryerja e vrojtimit në terren për gjendjen e mjedisit si: zhurma, cilësia e ujërave, biodiversiteti, trashëgimia kulturore, vrojtimit sociale etj
4.	Kryerja e vlerësimit të ndikimit duke marrë parasysh kërkesat e legjislacionit shqiptar (VENDIM Nr. 828, datë 28.12.2023 PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 686, DATË 29.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË AFATEVE PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM) DHE PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË VENDIMIT E DEKLARATËS MJEDISORE", TË NDRYSHUAR")
5.	Përcaktimi i masave zbutëse
6.	Organizimi dhe zhvillimi i Dëgjësës me publikun
7.	Dorëzimi i Raportit final të VNM-së së Thelluar tek institucionet përkatëse (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit)
8.	Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit dhe lëshimi i Deklaratës Mjedisore nga MTM dhe AKM

Tabela 1 Hapat e zhvillimit të VNM-së

Gjatë hartimit të Raportit të përcaktimit të çështjeve, për mbledhjen e të dhënave u zbatuan metodologjitë si më poshtë:

- Mbledhja e të dhënave të disponueshme të publikuara që lidhen me qëllimin e VNM-së.

■ Mbledhja dhe rishikimi i të dhënave respektive nga disa raporte VNM të mëparshme të hartuara nga kompania.

■ Zhvillimi i konsultimit me palët e interesit si një burim i rëndësishëm informacioni gjatë VNM-së.

2. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT

Ky aktivitet do të zhvillohet në Parkun Industrial Rashbull, ku ushtron veprimtarinë e saj shoqëria Brema Ambiente Sh.p.k e cila është e pajisur me leje mjedisore të tipit A dhe kryen mirëmbajtje të kushteve të lejes sipas ligjit në fuqi. Impianti parashikohet të vendoset në një sipërfaqe të sheshtë. Objekti kryesor është instalimi i furrës së djegies e cila do të shërbejë për incinerimin e mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve mjekësore dhe medikamenteve dhe do të shërbejë për nevojat e subjektit dhe aktivitetit që ushtron.

Territori ku shoqëria zhvillon aktivitetin e saj nuk cenon territoret e zonave të mbrojtura mjedisore, kurores së gjelber, hapësirës ujore rekreative, parkut urban, zonave të caktuara për agroturizem, kala, objekte fetare, rrenoja/arkeologji, ujera sipërfaqesore etj. Ajo gjithashtu është larg zonave të banuara, shkollave dhe kopshteve.




Fig. 1 Gjurma e projektit Kadastrale (Burimi ASIG)

KOORDINATAT SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV GAUS KRUGER		
	(E)	(N)
1.	4378795.626511498	4575234.833575444
2.	4378790.723414512	4575237.356454823
3.	4378789.766940108	4575235.264680332
4.	4378794.846714172	4575233.2881595725




Fig. 2 Zona Kadastrale (Burimi ASIG)

3. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT DHE QËLLIMI

Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
- Ndikimi ne flore/faune;
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti;
- Ndikime social-ekonomike;
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
- Ndikim ne peizazhin e zones.

Objektivi i dyte konsiston ne gjetjen e alternativave miqesore me mjedisin:

- Njohja me projektin dhe teknologjine e tij.
- Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis.
- Njohja me vleren natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes ku do te zhvillohet aktiviteti.
- Njohja me infrastrukturen ekzistuese dhe nevojten per infrastrukture te re per projektin.

Identifikimi i ndikimeve

Permes te cilit percaktohet nderveprimi mjedis-projekt dhe identifikohen ndikimet e mundshme.

Vleresimi i ndikimeve

Vleresimi i ndikimeve ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe perafrohet me objektivist me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

Shtrirja fizike

Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinor te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim.

Kohezgjatja e ndikimit

Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkohshem).

Kthyeshmeria

Vlereson mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te mepareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar).

Rendesia


Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekoheisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Qellimi kryesor i ketij projekti bashkekohor eshte qe te plotesoje te gjitha kushtet per te cilat do te operoje dhe gjithashtu per te vleresuar ndikimet mjedisore te mundshme te tij ne elementet toke, uje dhe ajer. Te gjitha proceset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para e deri ne perfundim, do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij.

Projekti ka për qëllim instalimin e një impianti; furrë për djegien e mbetjeve te rrezikshme, mbetjeve mjekesore e medikamenteve (furrë djegieje e mbyllur), në ambientet e Parkut Industrial të Rrashbullit.

4. PROCESI TEKNOLOGJIK

Djegia e mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve mjekësore dhe medikamenteve	
LDF-300 MODEL	
Numri i aplikueshem i shtreterve	300 – 500
Kapaciteti i djegies	200 – 300 kg / herë (kapaciteti ditor 3-6 herë)
Madhësia e furrës	2.25 m x 1.6 m x 3.8 m
Volumi i furrës	Dhoma e gazifikimit 2.4m ³ , Dhoma e djegies dytësore 1.2m ³ Dhoma e djegies finale 0.16m ³
Madhesia e mbushjes	900 mm x 1100 mm
Oxhaku	Lartesia 13 m Rrezja e jashtme Ø 400 mm
Fryresi	Fuqi 1.1 kw
Makineri djegese mbeshtetese	Fuqi 0.22 Kw Konsumi i karburantit 7-14 kg/h
Makineri ri-djegese	Fuqi 0.37 Kw Konsumi i karburantit 10-20 kg/h
Tensioni i punes	220 V
Pesha	Afersisht 9600 kg



Kur mbetjet vendosen në furrën e djegies, ato duhet të mbahen në një distancë të caktuar (jo më pak se 40 cm) nga djegësi kryesor i dhomës së djegies në anën e përparme në të djathtë. Mbetjet e produkteve plastike duhet të vendosen sa më larg që të jetë e mundur nga dalja e oxhakut për të shmangur një sasi të madhe tymi të zi për shkak të djegies direkte dhe që nuk mund të digjen plotësisht. Mbetjet mjekësore duhet të futen në thasë në furrë dhe sasia e çdo inputi nuk duhet të kalojë 80 % të vëllimit të përgjithshëm të dhomës së djegies në furrë. Duhet patur kujdes që mbetjet të mos grumbullohen në qendër, në mënyrë që ajri i djegies të mos jetë në gjendje të qarkullojë, në mënyrë që djegia të mos jetë e plotë. Mbetjet organike të djegshme duhet të jenë në sasi sa më të ulët të tilla si: benzinë, vajguri, bojë, hollues etj.

Gjatë mbushjes së furrës djegëse me mbetje, duhet të mbahet një distancë prej të paktën 10 cm përpara pjesës spërkatëse të flakës në anën e përparme në të djathtë të djegësit kryesor, për të shmangur uljen e efikasitetit të djegies apo dëmtimin e furrës djegëse.

Bulonat e derës së furrës duhet të shtrëngohen përpara ndezjes dhe fillimit. Gjatë shtrëngimit të bulonave, në vend të shtrëngimit të njëanshëm duhet të përdoret metoda e shtrëngimit diagonal, në mënyrë që të mos shkaktohet tym nga hapja e derës.

Vëllimi i ajrit të dhomës së gazifikimit, dhomës së djegies dytësore dhe dhomës së djegies finale duhet të rregullohet në kohë sipas llojeve të ndryshme të mbetjeve, dhe vëllimi i ajrit të dhomës së djegies duhet të zvogëlohet sa më shumë që të jetë e mundur gjatë fillimit. Çelësi duhet ndezur përpara se të ndizet dhoma e djegies dytësore dhe duhet siguruar që temperatura e dhomës dytësore të djegies të rritet në 300-400 ° C, përpara se të ndizet çelësi i dhomës së avullimit.

Për rregullimin e damperit të ventilatorit, duhet të instalohet një mbulesë rrjete në hyrjen e ventilatorit për të shmangur dëmtimin e teheve të ventilatorit të shkaktuar nga mbetjet që përthithen nga ventilatori. Amortizuesi i hyrjes së ajrit duhet të jetë në një pozicion plotësisht të hapur.

Furnizimi me energji elektrike nuk mund të ndërpritet menjëherë pas mbylljes automatike. Për shkak të temperaturës së lartë të furrës, ndërprerja e rrymës do të bëjë që ventilatori të ndërpresë funksionin e tij, kështu që furra nuk mund të ftohet, temperatura e lartë do të shkaktojë dëmtim të grykës së furrës dhe linjës së ndezjes me presion të lartë. Në rast emergjence, çelësi i mbylljes emergjente duhet të shtypet menjëherë për të zbatuar mbylljen emergjente. Temperatura e djegies duhet të kontrollohet në çdo kohë gjatë djegies. Kur mbetjet janë të vogla, koha nuk duhet të jetë më pak se 1 orë për të siguruar që mbetjet të digjen plotësisht. Gjatë djegies së mbetjeve, është e ndaluar të hapet dera dhe gjithashtu është e ndaluar të hapet dera e furrës para përfundimit të djegies, në mënyrë që të shmanget ekspozimi i flakës së hapur dhe incidente me personelin.

Pastrimi i hirit duhet të kryhet 8 orë pas përfundimit të djegies, temperatura e hirit të furrës duhet të ulet për të shmangur djegien apo incidente. Valvula e gazit dhe çelësi kryesor i furnizimit me energji elektrike duhet të mbyllen për një kohë të konsiderueshme.

5. MENAXHIMI I INSTALIMIT

Aktivitetet e parashikuara marrin në konsideratë masat e nevojshme për të siguruar që menaxhimi i tyre të kryhet pa dëmtuar shëndetin e njeriut dhe pa i sjelle dëme mjedisit, veçanërisht:

- *Pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën dhe faunën.*
- *Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.*
- *Pa dëmtuar peisazhin.*

Një synim tjetër është të përcaktojë e rekomandojë masa teknike organizative për zbutjen e ndikimeve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.

Në këtë aktivitet të subjektit do të punesohet një numer prej **2-3 punonjësish** për kryerjen e punës dhe funksionimin e saj në vazhdimësi.

Ndotja e mjedisit nënkupton shkarkimet e cdo lloj mbetjeje nga pjesë të materialeve të ndryshme në ujë, tokë, ajër e cila shkakton ose mund të shkaktojë probleme mjedisore të përkohshme ose të përhershme në balancën ekologjike të tokës, së bashku me zhvillim e madh që është bërë në industri të ndryshme.

Sipërfaqja ku planifikohet të zhvillohet aktiviteti ndodhet brenda koordinatave të Parkut Industrial Rrashbull, ku ushtron aktivitetin e saj kompania Brema Ambiente dhe planimetria e planifikuar për instalimin e teknologjisë, është e papërdorshme momentalisht. Sipërfaqe me përdorim ekzistues të pashfrytëzuar.

Rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja

Infrastruktura rrugore është ekzistuese kështu që nuk është e nevojshme hapja e rrugëve të reja. Impianti që do të instalohet është brenda ambjentëve ku zhvillon aktivitetin industrial kompania Brema Ambiente Sh.p.k dhe rrugët janë të shtruar dhe të sistemuara.

KUSHTET E PUNËS

Numri total i punonjësve	2-3
---------------------------------	-----

	ZYRA	PRODHIMI	MIRËMBAJTJA	MAGAZINIMI	TË TJERA
Shpërndarja e punonjësve	-	-	1		2
Turnet dhe aktivitetet	Zyrat / Administrata		Instalimet		
	8 orë 07 ⁰⁰ - 16 ⁰⁰		8 orë 07 ⁰⁰ - 16 ⁰⁰		
Orët e punës	Zyrat / Administrata		Instalimet		
			8 orë në ditë 8 orë/ditë x 24 ditë pune = 192 orë pune në vit		
Numri i orëve të punës në vit	8 orë/ditë x 24 ditë pune = 192 orë pune në vit				
Numri i ditëve të punës në vit	288 ditë/vit				
Periudhat gjatë të cilave kompania mbyllet	Pushimet		Dita e diel është gjithmonë pushim. Gjithashtu sipas kodit të punës, punëmarrësve u takojnë 24 ditë pushimi në vit.		
	Ndërprerje të rregullta të funksionimit		Aktiviteti nuk ka ndërprerje të rregullta të funksionimit.		

6. NDIKIMET NEGATIVE NË MJEDIS

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i aktiviteteve të propozuara është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme e të mundshme, të veprimtarise në mjedis gjate fazes se ndertimit dhe fazes se operimit te saj. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të veprimtarise, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh edhe lidhjet e tyre të ndërsjellta. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit. Ky raport është hartuar mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit

dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licencimin ose jo te aktiviteve te ndryshme.

Ndikime në ujëra

Nuk kemi ndotje të ujërave sipërfaqësore apo nëntokësore. Aktiviteti i cili do të zhvillohet "Furre djegieje për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve mjekësore dhe medikamenteve" është një aktivitet i cili zhvillon një cikël të mbyllur pune dhe nuk përdor ujë për proceset e punës apo proceset teknologjike, për rrjedhojë nuk ka shkarkime ujërash të ndotura në trupat ujore.

E gjithë sipërfaqja mbi të cilën do të instalohet linja teknologjike është e shtruar me beton.

Shkarkimet në ujë

SHKARKIMET NË UJË	IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT			
	PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË		NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Ndikimet e projektit në modelin e dranazhimit të tokës		x		x
Ndryshimet e nivelit të ujërave		x		x
Ndikimet e ndotësve në cilësinë e ujit		x		x

Ndikime në tokë

Ndikimet në tokë, gjeologji dhe terren nuk ka, pasi në këtë projekt nuk parashikohen të kryhen ndertime. E gjithë sipërfaqja e aktivitetit është e shtruar me beton të forcuar, ashtu si dhe të gjitha rruget brenda subjektit.

IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT	
-------------------------	--

SHKARKIMET NË TOKË	PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË		NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Ndikimet në tokë		x		x
Humbje e tokave		x		x
Ndryshimi i relievit te tokës		x		x
Erozion i tokës		x		x
Kontaminimi i tokës nga rrjedhjet		x		x
Prishje e tokës bujqësore		x		x

Ndikime në ajër

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka emetime në ajër. Impianti kryen punen e tij ne nje cikel te mbyllur dhe nuk ka shkarkime te gazeve te demshme per mjedisin. Furra eshte e pajisur me filtra te thate per pastrimin e ajrit te ndotur, sipas skemes teknologjike.

Pajisja është totalisht e mbyllur, me përmasa të vogla, me efikasitet të lartë djegieje. Ka një teknologji të lartë mjaft inovative jo të rrezikshme. Furrat e djegies me djegie të drejtpërdrejtë kanë shumë pak pluhur të krijuar gjatë procesit, krahasuar me llojet e tjera. Inceneratori i mbetjeve i llojit YDF aplikon metodën më të avancuar të djegies së gazifikimit me pirolizë primare + djegie të përzier me ajër të ambientit + djegie dytësore + trajtim djegieje. Kjo pajisje me teknologji të pirolizës së gazifikimit me temperaturë të lartë, ku temperatura më e lartë mund të arrijë 1200 ° C, adopton teknologjinë e pirolizës së gazifikimit, teknologjinë e djegies së përzier me dy faza, siguron që sterilizimi, dezinfektimi, pa tym dhe pa erë, të jetë në përputhje me standardet kombëtare të emetimit. Operacionet plotësisht të mbyllura, të cilat zbatohen për trajtimin e mbetjeve infektive, shmangin ndotjen dytësore.

Emetime pluhurash mund të vijnë nga levizja e mjeteve të transportit, nga transporti i lëndës së parë, por që këto mjete do të kontrollohen periodikisht dhe do të mirembahen për të patur shkarkime minimale.

Shkarkimet në ajër

SHKARKIMET NË AJËR	IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT			
	PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË		NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Lëndë të veçanta		x		x
Aroma sulmuese		x		x
Ndikime të tjera klimatike		x		x

Ndikime në zhurma

Nuk ka vibrime shqetësuese në zonën e objektit. Zhurmat në këtë zonë janë të papërfillshme, dhe plotësojnë normativat sipas legjisllacionit në fuqi. Ky aktivitet nuk përfshin procese pune të komplikuar dhe procesi teknologjik që zhvillohet është i mbyllur, duke mos ndikuar asnjë moment në mjedisin e jashtëm rrethues.

Në rast të emetimit të zhurmës, ky aktivitet duhet të plotësojë kriteret dhe kushtet e Udhëzimit Nr. 5, datë 26.11.2010 "Për lejet e thjeshta mjedisore të cilat lëshojnë zhurma në mjedis", Udhëzimin nr.8 datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuar", i cili përcakton vlerat e lejuara të zhurmës.

LLOJI I NDIKIMIT NGA ZHURMAT	IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT			
	PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË		NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka

Rritja e nivelit të zhurmave si rezultat i punës së pjesëve përbërëse të impiantit		x		x
Nivel më të lartë të zhurmave për banorët afër zonës		x		x

Ndikim në Trashëgiminë Kulturore

LLOJI I NDIKIMEVE NË TRASHËGIMINË KULTURORE	IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT			
	PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË		NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Ndryshime apo dëmtim të zonave arkeologjike, apo me vlera historike e kulturore		x		x

Ndikimet Socio-Ekonomike

Ky aktivitet ka nje ndikim socio ekonomik pozitiv, duke sjelle nje numer personash te punesuar nga zona perreth.

LLOJI I NDIKIMEVE SOCIO EKONOMIKE	IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT			
	PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË		NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Ndryshime socio ekonomike		x		x

NDIKIMI NE KLIME

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtimin e eres, apo sasine e reshjeve. Kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

RREZATIM JO-JONIZUES

Aktiviteti nuk shoqerohet me rrezatim jo-jonizues.

NDIKIMI NE POPULLESI

Realizimi i projektit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit ku do zbatohet projekti. Gjate funksionimit te impiantit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje te cilat ndosin ambientin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullsisë se rajonit.

NDIKIME NE FLORE DHE FAUNE

Zona në te cilen ushtrohet aktiviteti është një zonë pa elemente te spikatur te flores dhe faunes. Keshtu qe zhvillimi i ketij aktiviteti nuk ndikon ne te. Subjekti do te shtoje siperfaqet e gjelberta per nje pamje vizuale me te kenaqshme per syrin dhe per te mirat ne pikepamjen mjedisore.

7. MASAT KRYESORE LEHTËSUESE

Masat lehtësuese që do të ndërmerren gjatë ndërtimit dhe operimit

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga kontratuesit për zbatimin e projektit. Ndikimet negative në mjedis gjatë shfrytëzimit të objektit janë në nivele të ulëta. Disa prej masave kryesore që do të ndërmerren janë përmendur në mënyrë të përmbledhur si më poshtë shënuar.

Lloji i masave për mbrojtjen e mjedisit ndahen në:

1. Masa teknike

2. Masa organizative

Kuadri i masave Teknike dhe Organizative

MASA	MËNYRA
Kontrolluese	- Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit. - Kontrolli periodik i gjendjes së pajisjes. - Zbatimi rigoroz i sigurisë gjatë punës.
Ndërhyrëse	- Riparim i menjëhershëm i defekteve dhe avarive të pajisjes. - Njoftim i menjëhershëm i autoriteteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikës, autoambulanca).
Administrative	- Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi e instalimit sipas skemës/manualeve dhe rregullave. - Ndarje e përgjegjësisë dhe adresimi i saktë për raste të incidenteve/aksidenteve gjatë procesit të punës dhe mënyrat e veprimit.

Masat teknike, proceset selektive dhe kontrolli i ndotjes

- Pastrimi periodik i pajisjes së djegies nga mbetjet e gjeneruara (çdo 8 orë pastrimi i hirit) dhe pastrimi i ambientit të jashtëm rreth e rrotull ambientit ku do të vendoset instalimi.
- Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara (mbetjet e hirit të gjeneruara, të cilat do të depozitohen në landfillin e mbetjeve industriale, sipas skemës së ndarjes qelizore).
- Respektimi i orareve të punës.
- Plotësimi dhe respektimi i kushteve teknike të operimit të punës.
- Përdorimi i pajisjeve/aparaturave të Certifikuara sipas Standartit European.

- Sigurimi i ambienteve të punës.
- Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave.
- Respektimi i kushteve teknike dhe standarte.
- Zbatimi i rregullores së brendshme.
- Inspektim vizual ditor.
- Përdorimi i mjeteve të kolauduara.
- Pajisje për mbrojtjen individuale (PMI) të punonjësve gjatë proceseve të tyre të punës.

8. MONITORIMI I PLANIFIKUAR

Qëllimi i monitorimit mjedisor

Te sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standartet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e monitorimit

- Krahasimi i cilësive dhe gjendjes së mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të instalimit.
- Monitorimi i emetimeve (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit, në përputhje me normat dhe standartet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Përcaktimi i ndryshimeve të mundshme mjedisore si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti, ku kryhet funksionimi dhe nëse ka lidhje me impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Përcaktimi i efektivitetit të masave përmirësuese të zbatuara.
- Përcaktimi i impakteve afatgjata (nëse ka).

- Percaktimi i zgjatjes se kthimit ne normalitet te cilesise se mjedisit ne rajon, ne rastet kur vleresohet se ka ndikime dhe impakte ne te.
- Krijimi i nje arkive (regjistri) te cilesise se mjedisit, nje baze te dhenash qe do te mund te perdoret ne te ardhmen.

Plani i Menaxhimit të Mjedisit

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marrëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PMM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet.

Kualifikimi i personelit dhe masat mbrojtëse të përgjithshme. Duhet theksuar që menaxhimi mjedisor është në interes të të gjithëve kundrejt plotësimit të kërkesave. Duhet të zhvillohet një menaxhim mjedisor i detajuar dhe një program trajnimi.

Përbërësit kryesorë të këtij programi duhet të ndërthuren si më poshtë:

- Informacion i përgjithshëm.
- Mirëkuptim i informacionit të përgjithshëm, i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsytet për një menaxhim mjedisor të mirë.
- Përdorimi i pajisjeve të Certifikuara sipas Standartit European dhe Kolaudimi periodik i pajisjeve/aparaturave.
- Respektimi i orareve të punës brenda ambientit ku zhvillohet veprimtaria.
- Respektimi i masave teknike të punonjësve, sipas rregullores së brendshme.
- Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara.
- Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve çdo fillim viti për mirëfunksionimin e tyre.
- Zëvendësimi i menjëhershëm të pjesëve të pajisjeve dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme.

- Mbajtja e pajisjeve të nevojshme nga punonjësit për operimin e punës si : doreza, kufje per zhurmat; syze etj, sipas nevojës dhe proceseve që zhvillohen.
- Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, mbetjeve etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore përsa i përket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat C1, C2, C5, C7, C8 të Vendimit Nr. 1189, datë 18.11.2009 "Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë".

Investitori do të monitorojë këto tregues të trysnisë në mjedis gjatë fazës operative:

- Për ajrin, aplikohen detyrime.
- Për ujin, nuk aplikohen detyrime.
- Për zhurmat, aplikohen detyrime.

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të lejes së mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi, detyrimi për raportim për lejet e tipit A çdo 3 (tre) muaj ose 4 (katër) here në vit.

